



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2020:094995

Datë: 02.04.2025

Numri i dokumentit: 07075785

C.nr.925/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Xh. I. nga fshati Zh. Komuna e I. dhe M. L. me vendbanim në N., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Liridon Tafa, avokat në P.kundër të paditurit M. D. nga fshati N. Komuna P.me bazë juridike kompensim borxhi, vlera e kontestit 7.000.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik me datë 17.03.2025, në prezencën e të autorizuarit të paditësve e në mungesë të palës së paditur, mori, kurse me datën 02.04.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit M. L., ashtu që DETYROHET i padituri M. D., që paditësit M. L. të ia paguajë borxhin për shitblerjen e Kamionit të markës ....., tipi M .... modeli ..... MLC me numër të shasisë ....., në vlerë prej 7,000.00 Euro (shtatë mijë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 11.08.2020, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, e nën kërcënimin e përmbarimit.
- II. DETYROHET i padituri që paditësit M. L. në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumën prej 509.00 €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.
- III. REFUZOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit Xh. I., ashtu që DETYROHET i padituri M. D., që paditësit Xh. I. të ia përmbush detyrimin në emër të borxhit në vlerë prej 7,000.00 Euro (shtatë mijë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 11.08.2020, e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

## A r s y e t i m

### I. Historiku i procedurës:

Paditësi Xh. I. nga fshati Zh. nga Komuna I. përmes përfaqësuesit të tij me prokurë, ka parashtruar padi në Gjykatën e titullit me datë 11.08.2020 kundër të paditurit M. D. nga fshati N. komuna e Pejës më bazë juridike kompensim borxhi. I autorizuari i paditësit me datën 12.11.2020 ka dorëzuar në gjykatë një parashtrësë, për rregullimin dhe precizimin e kërkesëpadsisë në aspektin subjektiv.

### II. Pretendimet e ndërgjyqësve

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në padi ka, ka pretenduar se më 03.02.2020 ka lidhur një marrëveshje kontraktuale me të paditurin M. D. nga fshati N., Komuna P.për shitblerjen e një automjeti transportues, konkretisht një kamioni të markës M., modeli ..... MLC, tip M.....0, me numër të shasisë ....., për shumën totale prej 7,000.00 euro, me afat pagese deri më 15.04.2020. Për shkak se automjeti nuk ishte i regjistruar në emër të paditësit, marrëveshja u formalizua përmes një para kontrate të hartuar te avokati, me dëshmitarin F. M nga fshati K.i R., Komuna P.ndërsa paditësi kishte autorizim nga ish-pronari për shitjen dhe tjetërsimin e automjetit. Pas shitjes, i padituri fillimisht ka komunikuar me paditësin, por më pas, veçanërisht gjatë dy muajve të fundit para afatit të pagesës, ka ndaluar çdo kontakt, duke krijuar përshtypjen se nuk ka pasur qëllim të shlyente borxhin që rridhte nga kjo shitblerje. Me parashtrësën e datës 15.12.2020, paditësi ka precizuar padinë në aspektin subjektiv, duke përfshirë edhe të paditurin e dytë, S. D. nga fshati V., Komuna I., me arsyetimin se kamioni ndodhet në pronën e tij në rrugën J. B., fshati V.. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe parashtrësave të mëparshme, duke vërtetuar se ndërmjet palëve është lidhur një parakontratë për shitblerjen e automjetit për shumën 7,000.00 euro, me afat pagesë deri më 15.04.2020. Kamioni i është dorëzuar të paditurit të parë M. D. me mirëbesim, por ky nuk e ka përmbushur detyrimin për pagesën, pavarësisht njoftimeve për kalimin e afatit dhe mungesës së vullnetit për të arritur një marrëveshje. Ndërkohë, i padituri M. D. ka shitur automjetin tek i padituri i dytë, S. D., edhe pse nuk kishte dokumentacionin e nevojshëm, ndërsa ky i fundit ka kaluar në posedim të automjetit nëpërmjet keqbesimit. Pas deklarimit të paditurit të parë dhe pohimit të borxhit ka tërhequr padinë në raport me të paditurin e dytë (S. D.) ku gjykata e ka konstatuar të tërhequr padinë në seancën e përgatitore të datës 14.11.2023. Në vijim të procedurës, për shkak se në certifikatën e kamionit figuron si pronar M. L., padia është

zgjeruar, duke e përfshirë si paditës. Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se është vërtetuar se palët kanë pasur një marrëdhënie kontraktuale dhe se paditësi e ka përmbushur detyrimin e tij duke dorëzuar kamionin në posedim të të paditurit të parë, ndërsa ky i fundit nuk e ka kryer pagesën. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, është konfirmuar se afati për pagesë ka kaluar dhe se nuk ka pasur gatishmëri për shlyerjen e borxhit. Duke u bazuar në këtë, paditësi ka kërkuar nga gjykata që padia të aprovohet në tërësi dhe të detyrohet i padituri për përmbushjen e detyrimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, të specifikuara në shumë prej 509 euro.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në padi, mirëpo në seancën e datës 18.12.2023 ka deklaruar se pranon se ka blerë kamionin nga paditësi, por nuk e ka paguar për shkak të pamundësisë financiare. Ai premtan se borxhin do ta shlyejë më së largu deri në maj të vitit 2024. Sipas tij, kamionin e ka blerë nga Xh., i cili i ka thënë se ai është pronar i tij, megjithëse kamioni ka mbetur në emër të vëllait të Xh.it. Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor i njejt i ka shpreh keqardhje për situatën dhe pranon se i ka borxh Xh.it. Megjithatë, ai beson se kamioni është pronë e M.it, bazuar në informacionin që ka marrë nga Xh.i. Ai shprehet i gatshëm që nga fundi i janarit të fillojë shlyerjen e borxhit me këste, nëse kjo pranohet nga pala tjetër.

### III. Provat e administruara

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike, sipas propozimit të palëve, në procedurën e të provuarit, i ka administruar këto prova: certifikata e automjetit të markës MAN ..... në emër të M. L., para kontrata e dt. 03.2.2020 në me të Xh. I. dhe M. D., kopjet e dokumentit identifikues për Xh. I. M. L. dhe M. D., një foto e kamionit tipit MAN, përgjigja nga Dogana e Kosovës e dt. 28.01.2025 së bashku me përgjigjen kërkesë të dt. 22.01.2025, konfirmomin e mbulesës së sigurimit dhe dudin doganor.

### IV. Vlerësimi faktik dhe juridik i gjykatës

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku e në lidhshmëri njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike – kontestimore duhet vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me date 03.02.2020 paditësi Xh. I. ka lidhur një marrëveshje kontraktuale me të paditurin M. D. nga fshati N., Komuna P.për shitblerjen e një automjeti transportues, konkretisht një kamioni të markës M....., modeli 1..... M., tip M....., me numër të shasisë ....., për shumën totale prej 7,000.00 euro, me afat pagese deri më 15.04.2020. Për shkak se automjeti nuk ishte i regjistruar në emër të paditësit, marrëveshja u formalizua përmes një para kontratë të hartuar te avokati. Fillimisht i padituri i ishte lajmëruar paditësit mirëpo veçanërisht kur është afruar afati i përmbushjes së prestimit i njëjti nuk i është lajmëruar dhe nuk ia kishte përmbushur detyrimin sipas marrëveshjes(Kontratës) së berë. Si përfundim, gjykata ka vërtetuar se paditësi Xh. nuk ka qenë pronar i kamionit në fjalë, por paditësi tjetër (vallai i paditësit Xh.) andaj paditësit M., si pronar i sendit, i lind e drejta për të kërkuar borxhin nga i padituri, ngase gjykata ka vërtetuar se kamioni është shitur nga Xh.i e në emër të M.it, e sipas autorizimit të dhënë nga ky i fundit.

Gjykata konstaton se nga provat e administruara në raport me objektin e kërkesëpadisë, gjykata ka aprovuar në tërësi se kërkesa e paditësit është e bazuar në prova dhe ligj, dhe atë për arsyet si në vijim, ashtu që nuk ishin Kontestuese në mes palëve faktet si në vijim:

Paditësi Xh. I. në cilësinë e të autorizuarit M. L. dhe i padituri M. D. kanë lidhur një parakontratë për shitblerjen e kamionit më 03.02.2020, për 7,000.00 euro, me afat pagese deri më 15.04.2020, kurse paditësi ia ka dorëzuar kamionin të paditurit M. D. në posedim. I padituri pranon se nuk e ka paguar shumën e dakorduar, por ka premtuar se do ta shlyejë borxhin deri në maj 2024.

Gjykata ka konstatuar se paditësi kishte autorizim për shitjen e kamionit, pasi këtë e ka vërtetuar përmes autorizimit të bashkangjitur ne prova nga i padituri, përfshirë para kontratën.

Gjykata sipas detyrës zyrtare i është drejtuar doganës së Kosovës që të siguroj dokumentacionin nese kamioni që është objekt kontesti ka hyrë apo jo ne territorin e Kosovës dhe në emër të kujt është hyrë përmes procedurave doganore. Ku Gjykata përmes parashtresës së datës 22.01.2025 ka njoftuar se dogana e Kosovës ka kryer verifikimet për kamionin M. .... M., tipi M....., me numër shasie ....., lidhur me kalimin e tij në pikën kufitare Dheu i Bardhë më 29.12.2018 dhe zhdoganimin e tij në Kosovë. Rezultati tregon se ky kamion nuk figuron si i zhdoganuar pranë Doganës së Kosovës. Ndërkohë, Byroja Kosovare e Sigurimit konfirmon se për këtë automjet është lëshuar polica e sigurimit me numër 02823819 në të njëjtën datë, me të dhënat e mëposhtme: siguruesi M. L., shteti N. dhe ngjyra e kuqe. Në përfundim, megjithëse kamioni ka kaluar kufirin dhe është siguruar, nuk ka të dhëna për zhdoganimin e tij në Kosovë.

Me dispozitën e nenit 8 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve përcaktohet se *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”*, ndërsa me dispozitën e nenit 245 të LMD-së (Ligjit Për Marrëdhëniet e Detyrimeve i datës 10 Maj 2012), përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, andaj në rastin konkret është vërtetuar se i padituri e ka për obligim që t’ia kompensojë shumën prej 7,000.00 euro, në emër të borxhit të mbetur.

Me dispozitën e nenit 33 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve përcaktohet se *Para kontrata detyron, në qoftë se i përmban elementet thelbësore të kontratës kryesore*. Në rastin konkret bashkangjitur në provat e administruara nga kjo gjykatë bashkangjitur gjejmë dhe para kontratën e datës 03.02.2020 e cila i përmban elementet thelbësore të lidhjes së kontratës ku mes palët kontraktuese në momentin e lidhjes së Kontratës kanë pasur aftësinë punuese, Pajtimi i vullnetit ku i njëjti vullnet është pohuar edhe gjatë deklaramit të paditurit gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor përmes pohimit të borxhit, Lënda e kontratës ka qenë objekti i këtij kontesti pra Kamioni M. ... M., tipi M....., me numër shasie ....., ndërsa sa i përket Bazës të kësaj kontrate ka qenë realizimi i shitblerjes e mjetit të lartcekur ku me këtë gjykata ka konstatuar se kjo para kontratë ka i përmban elementet thelbësore të kontratës kryesore dhe prodhon efekt detyrues për palët kontraktuese.

Me dispozitën e nenit Neni 438 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve përcaktohet se *“Me kontratën e shitjes detyrohet shitësi që sendin të cilin e shet t’ia dorëzojë blerësit dhe t’ia kalojë të drejtën e pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t’ia paguajë çmimin dhe ta pranojë sendin.”* Andaj në rastin konkret shitësi i ka dorëzuar sendin (Kamionin) e me qenë së kamioni ka qenë i pa doganuar me dorëzimin e dokumentacionit të kamionit përkatësisht certifikatë e automjetit të markës MAN me numër 3870 i ka dhënë mundësin për doganim dhe më pas regjistrim në emër të tij ku shitësi i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo dispozitë ndërsa blerësi shitësit nuk ia ka paguar çmimin brenda afatit të caktuar të cilin palët kontraktuese janë dakorduar që blerësi në këtë rast debitori të ja paguajë çmimin shitësit pra kreditorit. Po ashtu, bazuar në neni 245, të po këtij Ligji, ku përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhëniet detyrimeve ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Në rastin konkret rezulton se i padituri, duke mos e kryer detyrimin e tij që ka rrjedhur nga shitblerja e automjetit, i ka mbetur borxh paditësit në shumën e përgjithshme prej 7,000.00 €, me ç' rast ndërmjet palëve ndërgjyqëse krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e mos përmbushjen e borxhit paditësit, me aplikimin e dispozitave të lartë cekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është vendosur si në dispozitiv **I** të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pikës **II** të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata ka vendosur duke pasur parasysh faktin se paditësi, Xh. I., nuk ka pasur legjitimitet real aktiv në këtë procedurë, për shkak se objekti i kontestit – kamioni – nuk ka qenë i regjistruar në emrin e tij, por në emër të M. L.Ky fakt është vërtetuar përmes certifikatës së automjetit për kamionin e markës MAN 3870, e cila figuron në emër të M. L.t. Për më tepër, kjo rrethanë është konfirmuar edhe përmes përgjigjes së Doganës së Kosovës të datës 28.01.2025, si dhe përgjigjes në kërkesën e datës 22.01.2025, të cilat dëshmojnë mbulimin e sigurimit dhe pagesën e detyrimeve doganore për automjetin në fjalë. Në këto rrethana, gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka legjitimitet ku edhe sipas autorizimit LRP – nr.1657/20, vërtetohet se I njëjti është autorizuar nga vëllai I tij M. L. që të shesë kamion në fjalë tek personat e tretë. Sipas nenit 73. Par.1. të LMD-së, *“Kontrata të cilën e lidhë përfaqësuesi në emër të personit të përfaqësuar dhe në kuadrin e autorizimeve të veta, e obligon drejtpërdrejt të përfaqësuarin dhe palën tjetër kontraktuese.”* Pra veprimet e ndërmarra nga paditësi Xh. kanë qenë për, në emër dhe interes të paditësit M. L..

Duke u bazuar në nenin 319 par.1 të LPK-së, që përcakton se *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”* dhe nenin 322 par.2 të LPK-së, që përcakton se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”* rezulton se pretendimi i paditësit se i njëjti nuk është paguar në shumën prej 7,000.00 € për shitjen e kamionit nuk është rrëzuar nga i padituri mirëpo i njëjti detyrim vetëm është pohuar nga ai . Duke u bazuar në barrën e të provuarit, deklaratës së paditësit, dhe deklaratës se paditurit rezulton se i padituri nuk kishte paguar paditësin prestimin e kontraktuar për shitblerjen e automjetit.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit, 170 dhe 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket periudhës nga e cila duhet të filloj të rrjedhë kamata, gjykata vendimin e vet e mbështeti edhe në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, respektivisht pikës 14 (XIV) të tij sipas të cilës, *‘Për dëmet materiale, koha*

*e rrjedhjes së kamatës do të përlogaritet nga dita e ushtrimit të padisë në gjykatë’’, respektivisht në këtë çështje kontestimore nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, me datën 11.08.2020 e deri në pagesën definitive.*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës në dispozitivin **III**, Gjykata e bazon në dispozitën e nenit 452 par.1 të LPK- së ku parashihet se ‘ *Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqësore dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore’*’, dhe dispozitën e nenit 463 par.1 që përcakton se ‘ *Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën’*’, duke ia pranuar paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore të kërkuara – specifikuar në seancë në shumë prej 509 euro dhe atë: për padi shumë prej 104.00 euro, për 3 seanca të mbajtura nga 135.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2020:094995, C.nr.925/20, Dt.02.04.2025

Gjyqtari  
Vegim Maloku

---

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.